



| | | | |
|--|----|------------------------------------|------------|
| REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO | | | |
| MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTARSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKE INVESTICIJU - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS | | | |
| Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit | 02 | Nr.i Prot Broj Prot Prot.No. | 756 |
| Nr.i Faqeve Br.Stranica No. Pages | 02 | Data: Datum Date | 08.06.2018 |
| Prishtinë | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška Ulaganja
- Ministry of Diaspora and Strategic Investments

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm-Kancelaria Generalni Sekretara- Office of the Secretary

Nr. _____
Dt. 08.06.2018

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), në pajtim me nenin 17 (paragrafët 5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) dhe Rregulloren nr. 07/2011, Rregulloren nr. 14/2017, Rregulloren nr. 15/2017 dhe Rregulloren nr. 16/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011, në bazë të nenit 10, paragrafit 5 të Rregullores (MeD) nr.01/2016, për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit të projekteve për diasporën, rekomandimit të komisionit vlerësues për mbështetje financiare të personave fizikë (individëve), me nr. prot.752, i datës 07.06.2018, u.d. Sekretarja e Përgjithshme nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet lista e projekteve të përzgjedhura për subvencionim të personave fizikë (individëve), rekomanduar nga komisioni për vlerësimin e projektpropozimeve, me nr.të protokollit 752, i datës 07.06.2018 .
 2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e projekteve të përzgjedhura për subvencionim të personave fizikë (individëve), e cila fillon nga numri rendor një (1) dhe përfundon me numrin rendor 27 (njëzet e shtatë), me numër të protokollit 756/1 i datës 08.06.2018.
 3. Shpallja e rezultateve për aplikantët e kualifikuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është bazuar në kriteret ligjore të thirrjes publike.
 4. Vendimi hyn në fuqi pas afatit për trajtimin e ankesave të aplikantëve nga komisioni i veçantë për shqyrtimin e ankesave.
-

Arsyetim

Bazuar në Rregulloren nr. 01/2016 (MeD) për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit të projekteve për diasporën, si dhe vendimit nr.680, i dt.22.5.2018 për themelimin e komisionit vlerësues për vlerësimin e aplikacioneve të dorëzuara nga personat fizikë, në fazën preliminare, nga 45 aplikacione, kriteret e vlerësimit procedural-administrativ i kanë plotësuar 43 aplikacione (dyzet e tre).

Në fazën e dytë të procesit të vlerësimit- vlerësimet nga aspekti përmbajtësor, komisioni vlerësues, bazuar në kriteret e thirrjes publike për mbështetje financiare të personave fizikë (individë), ka vlerësuar se 27 (njëzet e shtatë) aplikacione të renditura sipas nenit 2 të këtij vendimi i kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike, prandaj janë kualifikuar për mbështetje financiare nga MDIS-i.

Komisioni vlerësues ka vlerësuar se 18 aplikacione (tetëmbëdhjetë) nuk i kanë plotësuar kriteret e thirrjes publike dhe, si rrjedhojë, nuk janë kualifikuar për mbështetje financiare.

Udhëzime juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa në afatin prej 5 ditësh, në komisionin e veçantë për shqyrtimin e ankesave, nëpërmjet arkivit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike.

Vendimi u dorëzohet:

- Kabinetit të Ministrit të Diasporës;
- Divizionit të Buxhetit dhe Financave;
- Departamentit Ligjor dhe
- Arkivit të MDIS-it.



Shyhrete Gosalci


u.d. Sekretare e Përgjithshme



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateške Investicije - Ministry of Diaspora and Strategic Investments

REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE
 STRATEGIC INVESTMENTS

Nr. Proj. 02
 Nr. Faqeve 756-1
 Nr. Stranica 01
 Data 08.06.2018
 Prishtinë

Lista: Projektet e përzgjedhura për përkrahje financiare për personat fizik (individ)

| Nr. | Emri i personit fizik | Titulli i Projektit | Shuma e subvencionuar |
|-----|-----------------------|---|-----------------------|
| 1 | Malborë Krajku | Mbrëmje koncentrale e kuartetit frymor | 1,300.00 |
| 2 | Reshat Sejdiu | Gratë me nevoja të veçanta, të shurdhura, të prezentojnë vlerën e trashigimisë kulturore me bashkadhëtarët tanë "Mirë se vini Diasporë në komunën e Gjilanit" | 1,500.00 |
| 3 | Gazmend Nela | Java e filmit shqiptar në Muntih | 2,500.00 |
| 4 | Enging Sylejmani | Ditët e Diasporës në Dragash | 2,000.00 |
| 5 | Albane Shala | Të rinjtë e diasporës dhe të arriturat e tyre | 1,500.00 |
| 6 | Ali Daci | Manifestimi tradicional letrar "Ora e Maleve" | 1,500.00 |
| 7 | Hasime Daka | "Besë" - Kuajtja e tradites dhe e kultures në Suharekë | 1,700.00 |
| 8 | Saranda Rugova | Si e njoh Kosovën | 1,200.00 |
| 9 | Shpresa Siqeca | Mrekullitë e artit popullor të Prizrenit | 1,500.00 |
| 10 | Liridon Isrefaj | Mirë se erdhët diasporë-Kosova ju mirëpret! | 1,000.00 |
| 11 | Rushit Ramabaja | Monografi për Iliaz Bobajn | 1,500.00 |
| 12 | Leon Duhanaaj | Organizim, parapërgatitje, trajnim dhe pjesëmarrje në organizim multikulturor në qytetin e Goppingemit | 2,000.00 |
| 13 | Taulant Azemi | Tryezë me të rinjtë nga Diaspora „Identiteti im dhe lidhja me origjinën" | 1,000.00 |
| 14 | Majlinda Kelmendi | Lidhja me origjinën | 1,500.00 |
| 15 | Hajrush Kurtaj | Shitja e librit "Në rrugën e Lirisë" | 1,500.00 |
| 16 | Valentina Marevci | Shtrëngimi i dorës | 1,000.00 |
| 17 | Suada A. Džogović | Shitja e librit Suada A. Džogović | 1,200.00 |
| 18 | Jeta Çitaku Cana | Cikël koncertesh ndërkombëtare nga ansambli vokalo-instrumental "Tiro de Soprano" | 1,500.00 |
| 19 | Meritona Limaj | Ditët e Diasporës në komunën e Suharekës | 1,500.00 |
| 20 | Alisa Fejzi | Orientimi i financave të diasporës në vendin e origjinës | 1,000.00 |
| 21 | Edon Agushi | PreFoto2018 | 1,500.00 |
| 22 | Bakt Ymeri | Revista "Shqiptari-Albancuzul" | 1,500.00 |
| 23 | Elmaze Nura | Teatri mes politikës dhe kulturës (konferencë) | 1,000.00 |
| 24 | Isalm Veliu | Monografia e Gollikut (Gallapi) | 2,000.00 |
| 25 | Ilir Muharemi | Ekspo për mërgatë | 1,000.00 |
| 26 | Ariana Bytyqi Fazliu | Ju jeni pjesë e atdheut | 1,000.00 |
| 27 | Ardita Muja | Ta ruajmë identitetin dhe t'i fuqizojmë lidhjet tona | 1,000.00 |
| | | Totali | 38,900.00 |

